



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 17.03.2025

Numër Protokoli: 2231/2025

A.nr.78/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.78/2025, të datës 14.01.2025, të parashtruar nga ankuesja A.S., kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si bazuar ankesa me numër A.nr.78/2025, e datë 14.01.2025, e parashtruar nga ankuesja A.S., në atë mënyrë që aprovohet pretendimi lidhur me shkelje procedurale, ndërsa, refuzohet pretendimet tjera si në ankesë.

II. Ndryshohet Njoftimi me numër protokoli 3691, i datës 14.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtar, në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00013763, grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit, si dhe Njoftimi i datës 30.10.2024, lidhur me fazën e verifikimit paraprak, ashtu që kandidati A.K., largohet nga lista e kandidatëve fitues si dhe nga lista e kandidateve që kanë plotësuar kriteret në verifikimin paraprak, ndërsa, pjesa tjetër e Njoftimit me numër protokoli 3691, të datës 14.12.2024 si dhe Njoftimit të datës 30.10.2024, mbesin të pandryshuara.

III. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 28.10.2024, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me refuzimin aplikacionit të ankuesit.

IV. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në procesin e verifikimit përfundimtar para emërimit sipas nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në atë mënyrë që emërimi i kandidateve fitues të behët vetëm pas sigurimit

të dëshmisë nga organi kompetent lidhur më mos angazhimin e tyre në funksione politike në 3 (tri) vitet e fundit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën IV të dispozitivit.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil A.S. (*tutje referuar ankuesja*), më datë 15.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 28.10.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me konkursin me numër të referencës RN00013763, grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit në SIA Gjakovë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në, dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (*në tekstin e mëtejme referuar: MASHTI*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 07.02.2025, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 7044/2024 e datës 24.12.2024 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00013763, grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit në SIA Gjakovë; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin e datës 28.10.2024 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Njoftimin e datës 14.10.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 16.01.2025; Vendimin Ref.10/Nr.Prott.774 të datës 04.11.2024 dhe Vendimin Ref.10/Nr.Prot.785 të datës 05.11.2024 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit për themelimin e Komisionit të Pranimt dhe Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimt; Listën e aplikantëve; Listën e verifikimit paraprak e datës 30.10.2024; Formularët e vlerësimit të eses datës 27.11.2024; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për kandidatët fitues datës 06.12.2024; Njoftimin me numër protokollit 3691 të datës 14.12.2024 për kandidatët fitues; Aplikacionin e kandidatit M.D i datës 08.04.2024 me dokumentacionet; Aplikacionin e kandidatit N.P i datës 02.05.2024 me dokumentacionet nga faqe; Aplikacionin e kandidatit A.L i datës 29.04.2024 me dokumentacionet ; Aplikacionin e kandidatit A.K i datës 26.04.2024 me dokumentacionet; Aplikacionin e kandidatit M.F i datës 23.04.2024 me dokumentacionet; Aplikacionin e kandidatit A.H i datës 26.04.2024 me dokumentacionet; Aplikacionin e kandidatit K.R i datës 15.04.2024 me dokumentacionet; Aplikacionin e kandidatit A.Zh i datës 28.04.2024 me dokumentacionet; Plotësimin e përgjigjes në ankesë datë 05.02.2025; Aplikacionin e Ankueses A.S te datës 16.04.2024 te bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit; Testin me Shkrim te Ankuese A.S;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është pjesërisht e bazuar, *sepse*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton së MASHTI, me datë 05.04.2024, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00013763, për grupin e arsimit, për pozitën “*Inspektor i Arsimit-SIA*

Gjakovë”, klasa profesional 1, numri i kërkuar katër 6, me afat të aplikimit nga data 06.04.2024 deri më datë 05.05.2024, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, rrjedhimisht në këtë konkurs kanë aplikuar njëqind (10) kandidat, ku katër dhjetë e pesë (45) nga kandidatet ka hyrë në listën e ngushtë.

Kjo procedurën e pranimit ka përfunduar me Njoftimin me numër protokollit 1269, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare, mirëpo pas ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga kandidates V.H, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.1178/2024 të datës 14.09.2204, ka aprovuar ankesën e palës ankuese ka anuluar Njoftimin me numër protokollit 1269, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare si dhe çdo veprim tjetër deri në fazën e verifikimit paraprak, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të MASHTI që të zhvillojë procedurën e pranimit për këtë pozitë nga faza e verifikimit paraprak.

Tutje në zbatim të vendimit të Këshillit, më datë 14.10.2024, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MASHTI, ka publikuar njoftimin duke i njoftuar kandidatët që kanë aplikuar se do të bëhet verifikimi paraprak në bazë të dokumenteve të bashkangjitura në SIMBNJ, kështu që si rezultat kësaj, ankuesja ka kaluar fazën e verifikimit dhe të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ankuesja është ftuar për të marr pjesë në testin me shkrim ku e njëjta ka grumbulluar gjithsejtë 49.8 pike dhe nuk ka arritur të kalojë në fazën tjetër të intervistës më goje.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në MASHTI, më datë 14.12.2024, ka publikuar Njoftimi me numër protokollit 3691, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për pozitën *Inspektor i Arsimit*, ku si rrjedhojë si kandidatë fitues kanë rezultuar tetë kandidatë: M.D. me 89 pikë, N. P. me 87.6 pikë, A. L. me 85.6 pikë, A.K. me 82.4 pikë, M.F. me 81.4 pikë, A.H. me 79.6 pikë, K.R. me 78.8 pikë dhe A. Zh. me 72.2 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se vlerësimi i testit më shkrim nuk ishte i real ku është vlerësuar 49.4 pik dhe nuk i reflekton aftësitë e mia dhe kishte parregullsi në vlerësimin e eses, mospublikim i listës së përgjithshme për pjesëmarrje në test më shkrim, mos respektim i kriterëve të konkursit ku si kërkesë është kandidatet të mos ushtror funksionon politik në tri vitet e fundit ndërsa të kandidat fitues ka të cilat ushtrorjnë funksione publike dhe po ashtu MASHTI nuk e ka zbatuar vendimin e këshillit pasi ka shtyer afatin për 15 dite jam vu në lajthim dhe kërkoje që konkursi në fjale të anulohet komplet.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i aktit të shpalljes së konkursit më numër të referencës: RN00013763, ka gjetur se si kriteret të përgjithshme formale, lidhur me këtë pozitë janë përcaktuar: *Të kenë së paku titull master (300 ECTS), Të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën e arsimit dhe Të mos kenë ushtruar funksione politike në 3 (tri) vitet e fundit*, ndërsa tek pika 5 e konkursit lidhur me dokumentet që duhet dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre është kërkuar: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështete se paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave*

në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; Kopjen e certifikatave të trajnimeve; Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rënda në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike”.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht:

Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet: *“1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t’i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t’u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”*

Nenit 39, paragrafi 1, 2, 7, 8, 9, 10 dhe 11, ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit.*

Kolegji i Këshillit, ju referua edhe Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, gjegjësisht nenit 7 paragrafi 1, nenit 8, nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *“7. 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 8. Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj. 11.1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat”.*

Ndërsa lidhur me kërkesat e përgjithshme formale, Kolegji i Këshillit, ju referua Ligjit Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 9 paragrafi 2, ku përç akthet: *“2. Inspektorët e arsimit zgjedhën në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbimin Civil. Përveç kushteve të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe këto kriterë:*

2.1. të kenë së paku titull master (300 ECTS); 2.2. të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në arsim. 2.3. të mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit”.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankueses se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me ligjin material, nuk qëndron, ngase duke ju referuar shkresave të administruara të lëndës, si dhe testit me shkrim, Kolegji ka konstatuar se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurat përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, dhe të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht testi ka përmbajtur 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja. Rrjedhimisht, duke u bazuar në shqyrtimin e testit të aplikuar në procedurën e kontestuar Kolegji nuk vëren te meta në vlerësimin e drejtë të ankuesit lidhur me testin më shkrim, pasi që ankuesi në testin me shkrim për procedurën e rekrutimit sipas referencës RN00013763, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Gjakove, ka dhënë 18 përgjigje të sakta duke arritur 36 pikë, ndërsa në vlerësimin e esësës është vlerësuar me 13.4 pikë, nga rrjedhëse pikët e grumbulluara në test janë pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.* Kështu që mbi këtë bazë rrjedhëse nuk janë të bazuar pretendimet e ankuesit për vlerësim jo të drejtë. Ndërsa në lidhje me pretendimin se listën fituese ka persona të cilët janë politik i mbetet organit të punësimit se para te beje akt emërimet e tyre te beje sqarime nga organi kompetent se nëse ka persona qe janë kandidat fitues te përzgjedhur dhe mbajnë funksione politike ne tri vitet e fundit dhe të njëjti duhet largohen nga lista ndërsa për shterjen e afatit nga ana e komisioni për shkak numrit te madhe te kandidateve kjo nuk munde te konsiderohet qe ka ndikuar ne proces.

Kolegji i Këshillit nisur nga mandati kushtetues dhe ligjor për sigurimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, e në kuptim të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka analizuar në kuptim të respektimit të ligjshmërisë veprimet administrative dhe procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit me numër të referencës RN00013763, ku si rrjedhojë ka gjetur së përbërja e Komisionit të Pranimit i emëruar sipas Vendimit Ref.10/Nr.Prott.774 të datës 04.11.2024 i ndryshuar vetëm pikë 2.1 me Vendimin Ref.10/Nr.Prot.785 të datës 05.11.2024 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit, është në pajtim me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: *“2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.”.*

Ndërlidhur me plotësimin e kriterëve të konkursit nga kandidatja fituese, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar dosjen e kandidatëve fitues respektivisht gjashtë kandidatëve fitues ngase në këtë konkurs janë kërkuar gjashtë pozita:

- Kandidatja M.D., posedon Diplomën me Nr. 713 të datës 10.07.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, e sipas të cilës dëshmohet se më datë 26.02.2014, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit në Programin Biologji-Kimi, duke marr titullin Bachelor i Biologji-Kimi, posedon Diplomën me Nr.526 të datës 02.10.2019 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, e sipas të cilës dëshmohet se më datë 18.09.2018, ka përfunduar master në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Master i

Edukimit-Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas Vërtetimit me Nr. 58/24 të datës 08.04.2024 të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Fehmi Agani", në Gjakovë nga data 21.10.2002 deri më datë 23.03.2016 ka punuar si mësimdhënëse e lëndës Kimi-Biologji, prej datës 24.03.2016 deri më datë 25.07.2021 në pozitën e Drejtorit të Shkollës si dhe nga data 16.07.2021 vazhdon në pozitën mësimdhënëse në lëndët Kimi-Biologji.

- Kandidati N.P. posedon Diplomën me Nr. 227 të datës 02.09.2003 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 11.11.1991, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik duke marr titullin Profesor i Historisë, posedon Diplomën me Nr.18 të datës 25.04.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", e sipas të cilës dëshmohet se më datë 10.04.2013, ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Master i Edukimit-Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas Vërtetimit Nr. pr.01/861 të datës 23.11.2022 të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë Ekonomike "Kasdri Kusari" në Gjakovë, nga data 01.09.2012 deri më datë 31.09.2016 si mësimdhënës i edukatës qlytetare dhe prej datës 01.09.2018 vazhdon në marrëdhënie pune në këtë pozitë, sipas Vërtetimit të datës 06.09.2018 të lëshuar nga MASHT i njëjti përgjatë vitit 2010-2018 ka qenë i angazhuar në cilësinë e ekspertit për hartimin e dokumenteve kutikulave, programeve mësimore për lëndën e Historisë.
- Kandidatja A.L. posedon Diplomën me Nr. 108 të datës 20.07.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 16.02.2016, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filologjik duke marr titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, posedon Diplomën me Nr.798/18 të datës 03.07.2018 të lëshuar nga Kolegji AAB, e sipas të cilës dëshmohet se më datë 03.07.2018, ka përfunduar studimet master në Gjuhë Angleze. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas Vërtetimit Nr. protokollit 7010/2023 të datës 02.06.2023 të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Selman Riza" në Gjakovë, nga data 05.12.2017 deri më datë 02.06.2023 si mësimdhënës e gjuhës angleze.
- Kandidati M.F., posedon Diplomën me Nr.27 të datës 04.12.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 26.09.2008 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Bachelor i Gjeografisë-Edukatë Qytetare, posedon Diplomën me Ne. 503 të datës 23.09.2019 të lëshuar nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin Aleksandër Moisiu në Republikën e Shqipërisë për kryerjen e studimeve më datë 29.09.2015 në Master i Shkencave në Menaxhim dhe Supervizim i Institucioneve Arsimore të cukën e ka të nostrifikuar sipas Vendimin Ref.Nr.2/6-2258 të datës 19.05.2023 të MASHTI-t. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas Vërtetimit me numër protokollit 2552/2024 të datës 22.04.2024 të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët Emin Duraku në Gjakovë, nga viti 2010 deri tani është në marrëdhënies punës në këtë shkollës si mësimdhënës i rregullt.
- Kandidati A.H. posedon Diplomën me Nr. 24 të datës 04.12.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, e sipas të cilës dëshmohet se më datë 14.07.2008, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Bachelor i Teknologjisë-Informatikës, posedon Diplomën e me Nr. 384/1214 të datës 01.12.2014 të lëshuar nga Kolegji FAMA, me të cilën dëshmohet se më datë 22.11.2014 ka përfunduar studimet Master në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas Vërtetimit me Nr.04/1777 të datës 19.04.2024 të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "Hysni Zjani", në Gjakovë, i njëjti nga data 07.06.2007 deri më datë 14.09.2008 si mësimdhënës i Teknologjisë Informatike, dhe prej datës 14.09.2008 deri vazhdon Sekretar, sipas Vërtetimit

të marrëdhënies së punës në vitin akademik 2015/2016 dhe 2016/2017, ka punuar si mësimdhënës në Kolegji Heimerer.

- Kandidatja A.K., posedon Diplomën me Nr.443 të datës 20.08.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 14.07.2010, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Baçelor i Programit Fillor, posedon Certifikatën e datës 23.06.2014 të lëshuar nga Kolegji Biznesi me të cilën dëshmohet se më datë 23.06.2014 ka përfunduar studimet master në Menaxhement dhe Financa. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas Referencës Nr. prot.1/137 të datës 23.08.2012 të lëshuar nga Instituti Arsimit Privat Mehmet Akif College, nga shtator 2011 deri në qershor 2012 ka punuar si mësuese e programit fillor, sipas Vërtetimit me Nr. 64/24 të datës 15.04.2024 të lëshuar nga Shkolla Fillore Fehmi Agani nga data 21.09.2014 vazhdon të punoj si mësimdhënës në këtë shkollë.

Kolegji i Këshillit, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, vlerëson se kandidatët fitues, M.D., N.P., A.L., M.F., A.H., kanë plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, Njësia e Personelit në fazën e verifikimit paraprak nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale duke e përfshirë kandidaten A.K., si kandidat që ka plotësuar kriteret formale, sepse siç u sqarua si me sipër, kandidatja A.K., si dëshmi lidhur me kriterin e arsimit ka ofruar vetëm Diplomën me Nr.443 të datës 20.08.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 14.07.2010, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Baçelor i Programit Fillor, dhe Certifikatën e datës 23.06.2014 të lëshuar nga Kolegji Biznesi me të cilën dëshmohet se më datë 23.06.2014 ka përfunduar studimet master në Menaxhement dhe Financa, e që në vlerësimin e Kolegjit dhe ashtu siç është përcaktuar më klauzolën Nr. 5 të Konkursit si dëshmi valide për të vërtetuar kriterin e arsimit të përcaktuar me konkursin përkatës është diploma për kryerjen e studimeve master.

Duke marr parasysh që lista fituese ndërlidhur me këtë konkursi rezulton me gjithsej tetë (8), kandidatë si: M.D., N.P., A.L., A.K., M.F., A.H., K.R. dhe A.Zh., dhe duke marr për bazë që përveç kandidates A.K., pesë (5) kandidatët tjerë plotësojnë të gjitha kërkesat e konkursit, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati i listës fituese i renditur në numrin shtatë (7) ka rezultat kandidat fitues edhe sipas konkursit me Nr. Reference: RN00013760, për grupin e arsimit, për pozitën “*Inspektor i Arsimit-SIA Pejë*”, dhe për këtë procedurë është vendosur sipas Vendimit A.nr.2022/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë si kandidate fituese në konkursin me Nr. Reference: RN00013763, për grupin e arsimit, për pozitën “*Inspektor i Arsimit-SIA Gjakovë*”, është kandidatja A.Zh., e cila posedon Diplomën me Nr. 136 të datës 20.12.20017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datë 17.07.2009 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit, programi Fillor duke marr titullin Baçelor i Programit Fillor, posedon Diplomën me Nr. 196 të datës 05.04.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se më datë 21.03.2013 ka përfunduar studimet master në Fakultetin Filozofik në Departamentin e Pedagogjisë duke marr titullin Master i Pedagogjisë. Ndërlidhur me përvojën e punës sipas Vërtetimit me Nr. 137/2024 të datës 26.04.2024 të lëshuar nga Shkolla Fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovës, dëshmohet se ë njëjta përvojë punës si mësimdhënës ka 20 vite.

Pra, mbi bazën e këtyre dëshmive rrjedhë se kandidatët fitues përveç kandidates A.K. kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale lidhur me pozitën përkatëse të punës, e duke qenë së të njëjtit kanë arritur numrin e pikëve të nevojshëm për tu konsideruar si kandidatë të suksesshëm, atëherë, më të drejtë Divizioni i Burimeve Njerëzore i organit të punësimit ka shpallur të njëjtit kandidat të suksesshëm për procedurën përkatëse të rekrutimit, siç përcaktohet me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimimit në Shërbimin Civil.

Theksuar si më sipër, dhe meqenëse nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale e karakterit procedural apo material, Kolegji vlerëson së procedura e pranimit sipas konkursit me numër të referencës: RN00013763, për grupin e arsimit për pozitën “*Inspektor i Arsimit-SIA Gjakovë*”, është zhvilluar në pajtim Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu që, duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovojë pjesërisht si të bazuar ankesën, të ndryshoj Njoftimin me numër protokollit 3691, të datës 14.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtar, në procedurën e pranimit me numër të referencës RN00013763, grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit, si dhe Njoftimin të datës 30.10.2024, lidhur me fazën e verifikimit paraprak, ashtu që kandidati A.K., largohet nga lista e kandidatëve fitues si dhe nga lista e kandidateve që kanë plotësuar kriteret në verifikimin paraprak, si dhe të lënë në fuqi Njoftimin e datës 28.10.2024, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me refuzimin aplikacionit të ankuesit. Ndërsa pjesë tjera të Njoftimit me numër protokollit 3691, të datës 14.12.2024 si dhe Njoftimit të datës 30.10.2024, mbesin të pandryshuara. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në procesin e verifikimit përfundimtar para emërimit sipas nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që emërimi i kandidateve fitues të behët vetëm që të gjithë nga kandidatet fitues të kenë siguruar dëshmi nga organi kompetent lidhur me mos angazhimin e tyre në funksione politike në 3 (tri) vitet e fundit, si kriter i përgjithshme formal për pozitën e shpallur.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.78/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses A.S.;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MASHTI dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*